



## VENDIM MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT

**Data e miratimit: 13 qershor 2017**

**Lënda nr. 2013-21**

**Thomas Rüsche**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 13 qershor 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka ERMENKOVA, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Noora AARNIO, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendor, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, vendosi si në vijim:

### **I. VENDIMET E PANELIT TË DATËS 11 JANAR 2017**

1. Me 11 janar 2017, Paneli ka marrë vendim lidhur me këtë lëndë, ku ka gjetur një shkelje të së drejtës së ankuesit dhe ka bërë rekondimet si në vijim:

#### **“PËR KËTO ARSYE, PANELI, NJEZËRI,**

1. **Konstaton** se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës.
2. **Konstaton** se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës;

2. **Gjen të përshtatshme**, duke i marrë parasysh gjetjet e mësipërme të tij të fakteve dhe ligjin, që t'i bëjë rekomandimet vijuese shefes së Misionit sipas Rregullës 34 të Rregullores së Punës:

- a. Që SHM-ja ta bëjë një deklaratë se e pranon që rr Ethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit, që i ngarkohen veprimeve dhe/ose mosveprimeve të EULEX-it Kosovë gjatë kryerjes së mandatit ekzekutiv të tij;
- b. Që SHM-ja duhet t'ju ofrojë për informim kopjen e këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse.”

## **II. INFORMACIONI I MARRË NGA SHEFJA E MISIONIT TË EULEX-it NË LIDHJE ME ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT**

2. Me letrën e datës 9 shkurt 2017, ShM-ja ka ofruar përgjigjen e saj në lidhje me rekomandimet e Panelit.
3. Në letrën e saj të datës 9 shkurt 2017, ShM-ja ndër të tjera ka thënë si në vijim:

“[...] mund t'ju informoj se vendimi i Panelit është përcjellë tek kryeprokurori i EULEX-it.”
4. Paneli është bindur që ShM-ja ka ndërmarrë hapa efektivë për të zbatuar rekomandimin e dytë të Panelit.
5. Nga ana tjetër, Paneli thekson që ShM-ja nuk e ka zbatuar rekomandimin e tij për të bërë një deklaratë që do të pranonte se rr Ethanat e rastit kanë përbërë shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen EULEX-it Kosovë gjatë përbushjes së mandatit të tij ekzekutiv.
6. Paneli shpreh keqardhje që nuk është bërë një deklaratë e tillë.
7. Duhet të theksohet se, në përputhje me Dokumentin e Konceptit të Llogaridhënisë të EULEX-it të tetorit 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, Paneli nuk ka juridiksim t'i jep urdhra *obligues* Misionit. E po ashtu as edhe mandati i tij nuk e mbulon mundësinë që Paneli t'i rekomandojë Misionit t'i paguajë dëmshpërblim ndonjë ankuesi të suksesshëm. Në mungesë të mënyrave të tillë të dëmshpërblimit në kornizën ligjore të Panelit, një deklaratë nga ShM-ja që do ta pranonte shkeljen e të drejtave të ankuesit në shumë raste do të shkonte në një farë mënyre drejt ofrimit të një korrigjimi për ankuesin, të cilit i janë shkelur të drejtat nga Misioni.

**PRANDAJ PANELI NJËZËRI,**

**Deklaron** se ShM-ja ka zbatuar rekomandimet në këtë lëndë vetëm pjesërisht,

**Përshëndet** shpërndarjen e vendimit të Panelit nga ana e ShM-së tek prokurorët e EULEX-it përmes kanaleve përkatëse, dhe

**Vendos** ta mbylli shqyrtimin e kësaj lënde.

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese